

UNMIK/REG/2007/18
9 maj 2007

RREGULLORE NR. 2007/18

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2001/19
MBI DEGËN E EKZEKUTIVIT TË INSTITUCIONEVE TË
PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke vepruar në pajtim me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Pas shpalljes së Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 për themelimin e Degës së Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/5 të datës 4 mars 2002, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/15 të datës 16 mars 2005, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/53 të datës 20 dhjetor 2005, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/19 të datës 22 prill 2006, Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/26 të datës 27 prill 2006 dhe të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/34 të datës 22 maj 2006 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19,

Duke vepruar me kërkesë të Qeverisë për të bërë ndryshimet në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 të paraqitura në shkresat nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal të datave 10 janar 2007 dhe 21 shkurt 2007,

Me qëllim të ndryshimit të Shtojcës XIV (Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 për t'i sqaruar funksionet e

Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe për t'i përcaktuar përgjegjësitë e reja për këtë ministri,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1 Ndryshimet

Nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Shtojca XIV e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 ndryshohet si në vijim:

1.1 Paragrafi (ix) i Shtojcës XIV ndryshohet si në vijim:

- (a) Ia përcjell Bordit të Pavarur për Mbikëqyrje (BPM) për të vendosur lidhur me çdo vendim ose veprim të ndërmarrë nga autoritetet lokale që kanë të bëjnë me procedurat e punësimit, zgjatjes së kontratës së punës, përtërimit të kontratës së punës, pezullimit nga puna dhe të pushimit nga puna të kryeshefave ekzekutivë dhe të drejtorëve komunal, të cilët Ministria i konsideron të jenë në mospërputhje me ligjet në fuqi dhe në rast të moszbatimit për shkaqe të paarsyeshme të vendimit dhe urdhërësës së BPM-së nga ana e autoriteteve komunale përkatëse, në bashkërendim me Kryeministrin e pezullon ose e veçon vendimin ose veprimin komunal në fjalë,
- (b) E ka diskrecionin për ta vlerësuar përputhshmërinë me ligjet në fuqi të çdo vendimi ose veprimi të natyrës së përgjithshme të ndërmarrë nga autoritetet komunale gjatë ushtrimit të kompetencave të veta, përveç atyre nga pika (ix), (a) më lart, dhe nëpërmjet të Kryeministrit për t'i bërë rekomandimet për pezullimin ose veçimin e vendimeve ose veprimeve komunale nga ana e PSSP-së në rastet kur është vërtetuar mospërputhja.

1.2 Në Shtojcën XIV, paragrafi aktual (ix) do të rinumërohet si paragrafi (x).

Neni 2 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 9 maj 2007.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm